



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.297/04

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtarja Shpresa Emra, në çështjen juridike të paditësit Asllan Sagdati nga fsh. Reçan KK Prizren, të cilën e përfaqëson i autorizuari av R. T. nga [redacted], kundër të paditurëve Q. A. nga fsh. [redacted], Q. A. nga fsh. [redacted] dhe Sh. A. nga fshati [redacted] të cilët i përfaqëson i autorizuari av. S. R. nga [redacted] për borxh, pas mbajtjes së shqyrtimit publik kryesor me dt.07.10.2013 mori këtë

A K T G J Y K I M

- I. **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesë padia e paditësit dhe **OBLIGOHET** i padituri Q. A. që në emër të borxhit të paguaj paditësit A. S. shumën prej **7.158,10€** me kamatë ligjore në këtë shumë që nga dita e marrjes së aktgjykimit gjerë te pagesa definitive.
- II. **REFUZHET** kërkesë padia e paditësit ndaj të paditurve Q. A. dhe Sh. A. që të dy nga fsh. [redacted] në tërësi si e **pabazuar**.
- III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi pjesën e aprovuar prej **7.158,10€** nga pjesa e kërkuar **në shumë prej 21.207,88€ refuzohet si e pabazuar**.
- IV. **OBLIGOHET** i padituri që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 1.100€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm .

Arsyetim

Pretendimet e palëve

Paditësi, respektivisht e autorizuari i tij ka parashtruar padi me të cilën ka cekur se me dt. 05.02.1997 të paditurit i ka dhënë borxh shumën prej 14.000DM me marëveshje që ky borxh të kthehet më së voni gjer më 15.04.1997. I padituri këtë borxh nuk e ka kthyer në afatin e përcaktuar andaj paditësi ka parashtruar këtë padi dhe ka kërkuar që i padituri të obligohet të paguaj borxhin në shumën e lartëcekur me kamatë që nga dita kur është përcaktuar që duhet të shlyej borxhin gjer tek pagesa definitive. Gjithashtu ka cekur se pasi që i padituri ka trashëguar palujtshmërinë nga babai i tij i cili në ndërkohë ka vdekur ka propozuar që gjykata ta caktojë masën e përkohshme me të cilën do të ndalohet shitja e palujtshmërive të cilat janë të evidentuar në emër të babait të paditësit A. A. me qëllim të parandalimit të shkaktimit të dëmit të pakontestueshëm dhe sigurimit se i padituri do të paguaj borxhin nga këto palujtshmëri. Me parashtrësia të parashtruara, fjalëve në shqyrtime të mbajtura i autorizuari i paditësit ka cekur se i padituri nëse nuk e paguan borxhin atëherë për këtë obligohet babai i tij sipas kontratës interne të përpiluar në mes të palëve

ndërgjygjëse pasi ai ka qenë garantues për pagesën e borxhit me palujtshmërinë e tij. Në ndërkohë babai i të paditurit ka vdekur dhe pas vetes ka lënë të bijtë e tij të paditurin O. [redacted] dhe djemt Q. [redacted] me Sh. [redacted] A. [redacted] sipas Aktvednimit të trashëgimisë T.nr.170/07 të dt. 08.11.2012, konsideron se edhe vëllazërit të paditurit kanë legjitimitet pasiv në këtë qështje juridike pasi ata e kanë trashëguar palujtshmërinë kontestuese nga babai i tyre dhe ka zgjëruar padinë edhe ndaj tyre. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i të paditurit ka propozuar që gjyka ta të aprovoj kërkesë padinë në tërësi si të bazuar dhe të obligohet i padituri O. [redacted] A. [redacted] që në emër të borxhit të paguaj shumën e valorizuar në Euro prej 21.207,53€ bazuar në mendimin e ekspertit finansijar me kamatë duke llogaritur prej dt. 03.10.2013 deri në pagesën definitive si dhe që ky borxh të paguhet me shitjen e palujtshmërive të cilët janë siguruar me aktvendimin e gjykatës për masën e sigurisë parc. Kad. Sipas kësaj mase të cilët janë të evidentuara në listën pos. Nr. 62 në emër të A. [redacted] A. [redacted] e cila palujtshmeri gjendet në fshatin [redacted] dhe që këtë të paditurit Q. [redacted] A. [redacted], O. [redacted] A. [redacted] dhe Sh. [redacted] A. [redacted] të pranojnë dhe të lejojnë ekzekutimin e të njëjtës. Bazueshmëria e kërkesë padisë është vërtetuar në bazë të provave të administruara pasi që nuk është kontestuese huazimi i shumës prej 14.000DM të cilat i padituri O. [redacted] A. [redacted] ka pranuar se ka marr borxh dhe gjithashtu ka shprehur gadishmëri për kthimin e të hollave sipas mundësisë pais që momentalisht nuk ka mundësi. Borxhi është dashur që të paguhet në dy këste. Kësti i parë prej 7.000DM deri më 05.03.1997 kurse pjesën tjetër prej 7.000DM gjerë më 15.04.1997 gjë që bazuar në ekspertizën e ekspertit dhe revalorizimin e borxhit i padituri duhet të obligohet të paguaj borxhin në shumë prej 21.207,88€. I ka kërkuar shpenzimet procedurale për përpilimin e padisë 100€, për 10 seanca me nga 100€, për ekspertiz 300€ dhe për taksa gjyqësore 50€ në shumë të tërësishme prej 1.450€.

I autorizuari i paditësve në përgjegje në padi ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesën nga padia pasi që gjendja faktike nuk është ashtu si është paraqitur në padi. Respektivisht është e vërtet që paditësi dhe i padituri kanë pasur një marrëveshje gojore kontraktuese në vitin 1995 ku paditësi i ka dhënë borxh të paditurit 6.000DM në muajin tetor kurse pas 3 muajve edhe 3.000DM dhe atë me kamatë mujore prej 8%. Këtë borxh i padituri ka paguar gjerë në fund të vitit 1996 por paditësi së bashku me familjen e tij faktikisht e ka detyruar që të nënshkruaj kontratën mbi borxhin të cilën as nuk e ka lexuar dhe sipas të cilës kërkon që t' i paguhet borxhi në shumë prej 14.000DM. Kjo kontratë interne është përpiluar në vitin 1997 dhe bazuar në nenin 371 të LMD përcaktohet se afati përgjithshëm i vjetërsimit të kërkesës është 5 vite si dhe kërkesa për pagimin e borxhit vjetërsohet në në kuptim të nenit 557 të LMD. Andaj e konteston borxhin në këtë drejtim si të vjetërsuar. E ka kontestuar caktimin e masës së përkohshme pa i dëgjuar palët dhe në këtë drejtim edhe ka parashtruar ankesë. Gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe dhe parashtresave të parashtruara gjatë gjykimit ka deklaruar se duke marrë parasysh që A. [redacted] A. [redacted] babai i të paditurit përcaktohet si garantues me pasurinë e tij sipas kontratës kontestuese nuk mund të qëndroj ky konstatim pasi që babai i këtu të paditurit tani i ndërë nuk e ka nënshkruar kontratën kontestuese dhe sipas dispozitave të Ligjit mbi marrëdhëniet obligative deklarata mbi garancionin duhet të jetë e përpiluar me shkrim dhe e nënshkruar nga ana e garantuesit dhe kjo nuk qëndron në rastin konkret. Në lidhje me këtë borxh ekziston edhe kontrata tjetër interne me të cilën i padituri O. [redacted] A. [redacted] është deklaruar se nëse nuk e paguan borxhin do ta lenë si hipotekë palujtshmërinë e tij personale i cili gjindet në qytetin e [redacted] në Vojvodinë të Republikës së Serbisë dhe nuk ka pasur nevojë që të caktohet garantues tjetër dhe të paraqitet babai i tij si garantues me pasurinë e përbashkët të familjes së tij. Sa i përket precizimit të padisë edhe ndaj vëllezërve të paditurit O. [redacted] A. [redacted], Sh. [redacted] e Q. [redacted] A. [redacted] konsideron se të njëjtin nuk është dashur që të përfshihen në këtë qështje juridike pasi që kontrata është e nënshkruar nga ana e të paditurit O. [redacted] A. [redacted] dhe

vëllazërit e tij nuk kanë pasur kurrfarë njohuri për këtë kontratë. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i të paditurve ka deklaruar se gjerë më vitin 1996 i padituri ka paguar paditësit në emër të borxhit shumë prej 5.280DM në muajin e nëntë të këtij viti dhe më pas ka paguar edhe 2160DM me datë 23.09.1996 pra gjerë në fund të vitit 1996 është paguar shuma prej 7.440DM. Nga kjo vërtetohet se ai ka marrë borxh por edhe ka kthyer shumën të caktuar. Më pas në vitin 1997 është lidhur kontrata për pagesën e borxhit në shumë prej 14.000DM ku në pikën e dytë të kësaj kontrate babai i të paditurit garantohet me pasurinë e tij pagesën e borxhit kurse vet paditësi ka deklaruar se borxhi i cili kërkohet është shumë prej 7.000DM dhe nga kjo rrjedh konstatimi se i padituri është detyruar që të nënshkruaj kontratën me kamata shumë të lartë e cila mund të konsiderohet kontratë me fajde dhe në këtë rast kjo kontratë që nga fillimi do të konsiderohej nulë. Më pas me dt. 06.05.1997 është nënshkruar edhe një kontratë gjithashtu me elemente të kontratës me fajde ku sërish borxhi është përcaktuar në shumë prej 14.000DM, por me mundësi që nëse nuk paguhet borxhi në formë garancioni të lihet shtëpia e të paditurit në [REDAKTUAR]. Sërish ka cekur se duke marrë parasysh që kontrata mbi borxhin është përpiluar në vitin 1997 dhe padia është parashtruar në gjykatë në vitin 2004 bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet të obligimeve konsideron se ka kaluar afati ligjor prej 5 viteve me të cilën vjetërohet kërkesa mbi borxhin. Gjithashtu kontrata mbi garancionin e obligon garantuesin vetëm nëse është përpiluar me shkrim dhe në të dyja raste në rastin konkret nuk përmbushen elementet për kërkesë të përmbushjes së borxhit nga ana e garantuesve. Ka propozuar që në bazë të lartcekurave të refuzoj kërkesë padinë si të pabazuar në kuptim të nenit 350 të LMD. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës për 6 shqyrtime me nga 100€, për përgjigje në padi 50 €, për ankesë në aktvendim mbi caktimin e masës së përkohshme 50€, për përgjigje në padinë e precizuar 50€ në shumë të përgjithshme prej 750€.

Gjykata pas vlerësimit të gjithë provave të gjitha veç e veç dhe së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK ka gjetur se kërkesë padia e paditësit është **pjesërisht e bazuar**.

Vlerësimi i provave

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike i ka administruar këto prova ka bërë leximin e kontratës interne mbi borxhin në gjuhën boshnjake të dt. 05.02.1997, ka bërë shiqimin në listën ps. Nr. 42 ZK Reçan të dt. 21.06.2004, ka bërë leximin e aktvendimit të trashigimis T.nr. 170/07 të dt. 08.11.2012, ka bërë shiqimin në çertifikatën e vdekjes me dt. 21.01.2013 për A [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], ka lexuar konstatimin e ekspertit finansiar Q [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] të dt. 20.09.2006, ka lexuar marrëveshjen mbi pagesën e borxhit intern në gjuhën boshnjake të dt. 06.05.1997, i ka dëgjuar në cilësi të paditurit paditurin O [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], paditësin A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] të paditurin Sh [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] të paditurin Q [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], dhe dëshëmitarin Xh [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], ka lexuar ekspertizën e ekspertit finansiar Q [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] të dt. 02.10.2013 dhe ekspertizën plotësuese të dt. 02.10.2013.

Me leximin e kontratës mbi borxhin të përpiluar me dt. 05.02.1997 në gjuhën boshnjake gjykata ka vërtetuar se është përpiluar kontrata në mes të kreditorit A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] dhe shfrytëzuesit O [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] në prani të dëshëmitarit A [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] dhe Xh [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] për borxhin në shumë prej 14.000DM i cili borxh duhet të kthehet në dy këste, kësti i parë respektivisht shumë prej 7.000DM duhet të kthehet gjerë më dt. 05.03.1997 dhe kësti i dytë në shumë prej 7.000 DM të kthehet gjerë më 15.04.1997. Nën pikën III. të kësaj kontrate është cekur se nëse nuk kthehet borxhi deri në këtë datë kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e obligimit me garancion të palujtshmërisë së babait të debitorit dhe nën pikën 4 qëndron se nëse në afatin e përcaktuar nuk përmbushet obligimi atëherë shumën e borxhit do të rritet për 100%.

Me leximin e aktvendimit të trashigimisë T.nr.170/07 të Gjykatës Komunale në Prizren me dt. 08.11.2012 gjykata vërtetoi se është shqyrtuar trashigimia e trashigimlënësit H. A. nga fsh. KK Prizren i cili ka vdekur me dhe ka lënë pas vetes pasurinë e palujtshme në fshatin ku si trashigimtar në këtë pasuri janë shpallur të bijtë Q. O. dhe Sh. A.

Me shiqimin në listën pos. Nr. 62 të dt. 21.06.2004 gjykata vërtetoi se A. A. është pronar në tërë këtë palujtshmëri në sipërfaqe prej 1.07,63 ari..

Konstatimin e ekspertit finansijar Q. S. të dt. 20.09.2006 gjykata nuk e ka marrë për bazë pasi që e njëjta është parashtruar me padi pa urdhëresë të gjykatës.

Me leximin e marrëveshjes mbi pagesën e borxhit të përpiluar në mes të palëve ndërgjyqëse me datë 06.05.1997 e cila e mbanë faksimilin e avokatit O. R. nga P. gjykata ka vërtetuar se e njëjta i ka elementet e kontratës interne të përpiluar në mes të kreditorit A. S. nga fsh. dhe O. A. debitor nga dhe me dëshmitarë Xh. S. Sipas kësaj marrëveshje debitori O. A. deklaron se ka pranuar borxhin në shumë prej 14.000 DM para një viti nga përpilimi i kësaj kontrate dhe të njëjtën obligohet që ta kthej në të kundërtën ai e lënë si hopotekë palujtshmërinë e tij e cila gjindet në të Vojvodinës r e Sërbisë e cila është në sipërfaqe prej 3 ari dhe 63 m2 ku është ndërtuar edhe shtëpia e ti j .Marrëveshja është e nënshkruar nga ana e kreditorit A. S., debitorit O. A. dhe dëshmitarit Xh. S.

Me dëgjimin e paditësit në cilësi të dëshmitarit gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka deklaruar se nuëk është e vërtet që borxhi e cila është paraqitur në padi me kontratë është i vitit 1997 pasi që realisht e njëjta është nga viti 1995. Ai ka deklaruar që kqa marr borxh fillilimisht 6.000 DM më pas 3.000DM por në ndërkohë ka kthyer 1440 DM duke paguar këstin mujor në shumë prej 480 DM në të cilën ka qenë e logaritur edhe kamata në lartësi prej 8%.Gjerë më vitin 1996 ka paguar 5.280DM më pas nuk ka qenë në gjendje që t ia paguaj shumën tjetër të borxhit dhe pas rpesionit të bërë nga paditësi në vitin 1997 është përpiluar kontrata mbi borxhin në mënyrë që të ikin kproblemeve.Është e vërtet se në kontratë qëndron se duhet paguar 7.000 DM si kësti i parë dhe më pas edhe 7.000 DM tjera si kësti i dytë si dhe gjithashtu në nenin 3 kemi cekur se nëse nuk paguhet ky borxh si garancion lihet palujtshmëria e babait të tij i cili ka nënshkruar dhe ka qenë dëshmitar me rastin e përpilimit të kësaj kontrate.Kjo kontratë është e lidhur për shkak të problemeve që kanë lindur në mes tyre dhe për këtë arsye është lënë garancë shtëpia e babait e jo e tij por më pas është e lidhur edhe kontrata tjetër me dt.06.05.1997 e cila është e përpiluar në mes të birit të paditësit dhe ka të bëj me borxhin e njëjtë ku përcaktohen afatet tjera të kthimit të borxhit.Kjo kontratë është e përpiluar nga ana e avokatit O. R. e nënshkruar si borxhli O. A. dhe kreditor A. S. i biri i A. dhe dëshmitar ka qenë Xh. S. Ka deklaruar se e pranon borxhin por borxhi nuk mund të jetë 100% me kamatë.Sipas tij borxhi është diku rreth 4.000 gjerë 5.000€ duke marrë parasysh borxhin fillestan dhe një pjesë edhe ka kthyer.

Me dëgjiin e dëshmitarit Xh. S. nga gjykata ka vërtetuar se ai ka deklaruar se ka qenë nënshkruer i kontratës për borxh me të cilën i padituri në vitin 1997 ka marr borxh në shumë prej 14.000DM nga babai i tij të cilën ka qenë i obliguar që ta kthej me dy këste gjerë më dt. 15.04.1997.e këtë kontratë babaia i të paditurit ka lënë garancion palujtshmërinë e tij dhe ka deklaruar se nëse i biri nuk e paguan borxhin ai do ta paguaj të njëjtën.Më pas është e vërtet që

është e lidhur edhe një kontratë dhe sipas kësaj kontrate i padituri ka lënë garancë shtëpinë e tij. Sa i përket borxhit para përpilimit të kontratës të vitit 1997 ai nuk e din se është paguar asnjë shumë nga borxhi i marrë dhe shumë prej 5.000€ të cilën e pranon i padituri si borxh të tij nuk mund të pranoj sepse shuma e cila duhet të paguhet është 14.000DM.

Me dëgjimin e paditësit A. S. nga fsh. KK Prizren gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka deklaruar se me të paditurin O. A. ka pasur një marrëveshje dhe i ka dhënë shumë prej 7.000 DM të cilat ai është obliguar që ta kthej në dy këste. Kjo marrëveshje ka qenë me gojë dhe më pas me qëllim të sigurimit të saj është e lidhur kontrata me shkrim në zyrën e vendit në Reqan. Kontrata është e nënshkruar nga ana e O. A. atij dhe si dëshmitar A. A. dhe Xh. S. A. ka qenë babai i të paditurit dhe i ndjeri ka deklaruar se garanton që djali i tij do të paguaj borxhin në të kundërtën ai do ta paguaj borxhin. Borxhi nuk është paguar që nga ajo kohë sa i përket vëllezërve Q. dhe Sh. A. ka deklaruar se ata s'kanë kurrfarë borxhi ndaj tij. Paditësi ka deklaruar se ia ka dhënë borxh të paditurit O. A. 7.000 DM të cilët më vonë janë bërë 14.000 DM respektivisht se i padituri nuk ka pasur mundësi që të kthej borxhin fillestar prej 7.000 DM dhe për këtë për çdo moskthim të borxhit lartësia është rritur në 14.000DM.

Me dëgjimin e paditurit Sh. A. dhe Q. A. gjykata ka vërtetuar se të njëjtit nuk kanë nënshkruar asgjë dhe nuk kanë kurrfarë dijeni për marrëveshjen e vëllaut të tyre si dhe garancionin të cilën e ka lënë babai i tyre pasi që ata jetojnë dhe punojnë në Bosnje dhe nuk kanë pasur kontrakt me babain dhe vëllaun.

Me leximin e ekspertizës së ekspertit Q. S. të dt. 02.10.2013 dhe ekspertizës plotësuese po me këtë datë gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka bërë llogaritjen e borxhit në shumë prej 7.000 DM dhe 14.000 DM. Sipas vendimit të gjykatës eksperti ka bërë revalorizimin dhe llogaritjen e kamatës si dhe konverzimin e borxhit prej 7.000 DM e cila sipas ekspertit ka konstatuar se borxhi kryesor duhet të jetë 3.580,00€ dhe kamata 7.193.45 € në shumë të tërësishme prej 10.773,45€ pra borxhi kryesor 7.000DM është barabart me shumë prej 3.580,00€ kurse për shumë prej 14.000DM në bazë të parametrave të cekur më parë ka llogaritur që duhet të paguhet shuma prej 121.207,88€.

Vlerësimi juridik

Gjykata në rastin konkret ka vërtetuar këtë gjendje faktike nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse kanë pasur një marrëdhënie detyrimore në mes tyre respektivisht së paditësi i ka dhënë borxh të paditurit një shumë të caktuar të hollave. Nuk është kontestuese se në lidhje me këtë borxh ata kanë përpiluar një kontratë interne mbi pagesën e borxhit e cila nuk i ka elementet të sakta për sa i përket lartësisë së borxhit si dhe kushteve të kthimit. Respektivisht në fillim është përcaktuar se borxhi është 14.000DM dhe janë përcaktuar dy afate të kthimit me nga 7.000 DM, është përcaktuar se përmbushja në rast të mospagesës së borxhit do të kërkohet që të paguhet nga palujtshmëria e babait të borxh marrësit dhe nuk është përcaktuar se cila palujtshmëri, sa e ka vlerën dhe në cilën mënyrë do të realizohet kjo ashtu si parashihet në kontratat mbi garancionin e pagesës së borxhit dhe në fund neni i fundit kushtëzues i cili përcakton se nëse nuk gjerë më afatin e dytë pagues nuk paguhet borxhi atëherë shuma do të rritet për 100% gjë që është joligjore dhe në kundërshtim me marrëdhëniet obligative në tërësi. Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të faktit se sa është borxhi dhe përcaktimit të saktë se me çfarë marrëdhënie obligative kemi të bëjmë ka administruar provat dhe i ka dëgjuar të gjithë palët ndërgjyqëse. Nga dëgjimi i palëve posaçërisht


paditësit dhe të paditurit të parë ka konstatuar se marrëdhëniet detyrimore në mes tyre kanë pasur një ecuri dhe nuk është kontestuese se i padituri herë pas here ka marrur dhe ka kthyer borxh paditësit dhe se kontrata mbi borxhin ka qenë vetëm rrjedh e këtyre marrëdhënieve. Vet paditësi ka pranuar se i ka dhënë borxh shumë prej 7.000 DM kurse i padituri ka qenë i gatshëm që të bëjë marrëveshje dhe të paguaj borxhin në shumë prej 5.000€ gjë që e vërteton gjykatën ka borxh i padituri dhe nuk është kontestuese se kemi një marrëdhënie obligative. Gjithashtu për gjykatën nuk është kontestuese se të paditurit e dytë dhe të tretë nuk kanë kurrfarë obligimi ndaj paditësit dhe se të njëjtit nuk kanë qenë pjesëmarrës në këtë marrëveshje në mes të paditësit dhe të paditurit të parë. Andaj edhe me këtë drejtim gjykata e ka refuzuar kërkesë padinë ndaj tyre duke konsideruar se borxhin e paguan ai i cili e krijon marrëdhënie obligative dhe merr borxh. Gjykata e ka aprovuar dhe ka pranuar që i padituri ka borxh shumë prej 7.158,10€ e cila është shuma e konvertuar prej 14.000DM por nuk e ka aprovuar me kamatë dhe të valorizuar sipas ekspertit finansiar pasi që i njëjti shumë e ka llogaritur me kamatë ndëshkuese për vonesë e cila është shumë e lart dhe të cilën e llogarisin bankat kosovare me rastin e pagesës së borxhit. Kjo kamatë nuk mund të llogaritet pasi që sipas nenit 379 të LMD-ës kjo lloj kamate nuk lejohet (kamate vonesës). Gjykata konsideron se borxhi i të paditurit është borxh në shume që është paraparë me kontratën mbi borxhin për të cilën mund të kërkohet kamata e rregullt ligjore në këtë shumë për shumën të cilat janë paraparë për mjetet e deponuara në bankat tona. Pjesëmarrësit në marrëdhënie detyrimi kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij neni 8 i LMD lidhur me nenin 245 të LMD e cila parasheh që kreditori në marrëdhënie detyrimi ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori ka për detyrë që të njëjtën ta përmbushin tërësi me përmbajtjen e tij. Lidhja e kontratës konsiderohet e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës neni 15 i LMD, Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveq nëse me ligj është caktuar ndryshe neni 51 i LMD joformaliteti i kontratës, pagesa e kamatës është paraparë me nenin 378 dhe 382 të LMD.

Vendimi mbi shpenzimet u muar në kuptim të nenit 452.2 të LPK pasi që pala e cila humb kontestin obligohet që palës tjetër t'i shpërblejë shpenzimet gjyqësore në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht shpenzimet duke marrë parasysh që pala paditëse ka pasur sukses të pjesërishtëm në këtë procedurë.

Në bazë të lartëcekurave gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr.297/04 të dt. 07.10.2013



exp
 1. Kuvendi i...
 2. Pr. Detyrë...
 07-07-14
Bjsh

KËSHILLA JURIDIKE; kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

exp
 1. Kuvendi i...
 2. Pr. Detyrë...
 25-07-14
Bjsh